



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/41

Datë: 26.02.2026

Në bazë të nenit 13, nenit 58 shkronja a) dhe h), Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040); nenit 42 shkronja a) dhe j) i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, ndërlidhur me nenin 50 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 12 paragrafi 1 shkronja d të ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të pushtetit Lokal numër 020-111/7 datë 23.02.2026, Kryetari i Komunës me datë: 26.02.2026 i propozon Kuvendit të Komunës këtë:

Propozim: VENDIM

Për

- I. Rishqyrtimin e Vendimit numër 002/05 të datës 02.02.2026, për miratim e Vendimit për publikimin e listës së përgjithshme të pronave në posedim të komunës së Junikut si dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për personat fizik dhe juridik gjatë vitit 2026, të miratuar në mbledhjen e Kuvendi Komunal të Junikut datë 02.02.2026.
- II. Të korrigjohet lista e pronave e punuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, duke i shtuar këto të dhëna: Të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës, sipas rekomandimit numër 020-111/7 datë 23.02.2026 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- III. Pjesa tjetër e Vendimit të Kuvendit numër 002/05 datë 02.02.2026, të mbesin në fuqi dhe të pandryshuara.
- IV. Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit Komunal;
- Arkivit.

